



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 3134 Prot.

Tiranë, më 2.6. 2021

UDHËZIM

Nr. 11, datë 2.6.:2021

“PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 15.5.2019
“PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Pika 9, e germës “C”, të kreut II të udhëzimit nr. 10, datë 15.05.2019, të ndryshuar, riformulohet si më poshtë:

“9. Kuotat e paplotësuara në përfundim të raundit të parë për çdo program studimi, mund të përshtaten nga IAL në programe të tjera studimi të të njëjtit cikël të ofruara brenda të njëjtës njësi kryesore, pa kaluar totalin e kuotave për njësi kryesore, dhe njofton zyrtarisht MASR për vendimin e senatit akademik mbi përshtatjen e kuotave të programeve të studimit jo më vonë se 3 (tre) ditë pune nga data e fillimit të aplikimit për regjistrim nga kandidati për raundin e dytë. Në rast se përshtatja e kuotave është sipas përcaktimeve ligjore, MASR njofton IAL-të, RASH dhe QSHA, për konfirmimin e përshtatjes së kuotave para fillimit të periudhës së aplikimit për raundin e dytë.”

2. Pas pikës 4, të germës “E”, të kreut II të udhëzimit, shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. Kuotat e paplotësuara në përfundim të raundit të dytë për çdo program studimi, mund të përshtaten nga IAL-të në programe të tjera studimi të të njëjtit cikël të ofruara brenda të njëjtës njësi kryesore, pa kaluar totalin e kuotave për njësi kryesore, dhe njofton zyrtarisht MASR për vendimin e senatit akademik mbi përshtatjen e kuotave të programeve të studimit, jo më vonë se 3 (tre) ditë pune nga data e fillimi të aplikimit për regjistrim nga kandidati për raundin e dytë. Në rast se përshtatja e kuotave është sipas përcaktimeve ligjore, MASR njofton IAL-të, RASH dhe QSHA, për konfirmimin e përshtatjes së kuotave para fillimi të periudhës së aplikimit për raundin e tretë”

3. Në fund të pikës 7, seksioni G, kreu III, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Pas përfundimit të 3 fazave 48-orëshe të regjistrimit të raundit të tretë, IAL-të nuk mund të bëjnë më përshtatje të kuotave të paplotësuara të një programi studimi në programe të tjera studimi të të njëjtit cikël të ofruara brenda të njëjtës njësi kryesore”.

4. Pika 16 e kreut IV/1, 15 e kreut IV/2, germa “f”, e pikës 13 të kreut IV/3, pikat 16 e kreut IV/4, 23 e kreut IV/5, 16 e kreut IV/6, ndryshojnë si më poshtë:

“IAL-të brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, dërgojnë pranë QSHA-së, listën e studentëve të regjistruar, në formë shkresore dhe elektronike në format Excel me qëllim pajisjen me numër matrikullimi, sipas programit të studimit dhe tipologjisë së kandidatit. IAL-të nuk duhet të dërgojnë në QSHA të dhëna e asnjë kandidati pas kësaj date. Për të gjithë emrat kandidatëve të dërguar pas kësaj date ose që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin në fuqi, nuk do të procedohet me dhënien e numrave të matrikullimit dhe QSHA-ja duhet të kërkojë nga IAL-ja, duke njoftuar edhe kandidatin, çregjistrimin e tyre dhe konfirmimin me shkresë zyrtare brenda një afati 10 ditor për kryerjen e procesit të çregjistrimit të kandidatit nga IAL.

5. Kudo në përmbajtje të udhëzimit nr. 10, datë 15.05.2019, të ndryshuar, togfjalëshi “... përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi” të zëvendësohet me togfjalëshin “... përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik”.
6. Shtojca nr. 10 shfuqizohet.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

EVIS KUSHI

